VENDIM
Nr. 290, datë 23.12.2024

MBI KËRKESËN PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË KONTROLLON INTERESAT E SHOQËRISË "SA-GLE KOMPANI" SHPK

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 5, 7, 9, pika 5, dhe nenit 10, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.12.2024, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 1832/9 prot., datë 20.12.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, "Mbi heqjen e pezullimit të vendosur me vendimin nr. 151, datë 10.6.2022, 'Mbi kërkesën e shoqërisë 'SA-GLE Kompani' sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj' dhe dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë 'SA-GLE Kompani' sh.p.k.",

konstatoi se:

- Shoqëria "SA-GLE Kompani" sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 123, date 29.8.2012, për një afat 30-vjecar.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 633 prot., datë 5.5.2022, shoqëria ka paraqitur kërkesë dhe dokumentacion për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 151, datë 10.6.2022, u vendos pezullimi i vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, në lidhje me kërkesën e shoqërisë "SA-GLE Kompani" sh.p.k., për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj, duke i lënë detyrë shoqërisë që të dokumentojë në ERE vendimin përfundimtar të organeve përkatëse, në lidhje me heqjen e sekuestros mbi kuotat dhe transferimin e 100% të kuotave të saj.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1832, datë 28.8.2024, nga Zyra e Përmbarimit Privat "TDR Group" sh.p.k., si dhe shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1832/4 prot., datë 17.10.2024, nga shoqëria "SA-GLE Kompani" sh.p.k. u depozitua dokumentacion se nuk ka më asnjë procedim penal të regjistruar në ngarkim të shoqërisë. Sa më sipër, rezulton se nuk ekziston më kushti pezullues i vendimit të bordit nr. 151/2022. Në të tilla rrethana vlerësohet të hiqet ky pezullim dhe të vijohet me shqyrtimin e dokumentacionit përkatës për kërkesën e shoqërisë për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj.

- Pas shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar, ERE, me shkresën nr. 1832/5 prot., datë 4.11.2024, i evidentoi shoqërisë informacionin/dokumentacionin e munguar të aplikimit të saj.

- Në vijim, me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1832/6 prot., datë 21.11.2024 dhe nr. 1832/8 prot., datë 16.12.2024, shoqëria ka depozituar informacionin dhe dokumentacionin e munguar.

- Pas analizimit të kërkesës dhe dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria me korrespondencën vijuese të realizuar me ERE-n, rezulton se ajo ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar në nenin 7, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit

dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021.

- Shoqëria "SA-GLE Kompani" sh.p.k. nuk ka detyrime të pashlyera ndaj ERE-s për sa i përket pagesave të rregullimit.

- Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë "SA-GLE Kompani" sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Heqjen e pezullimit të vendimmarrjes për aplikimin e shoqërisë "SA-GLE Kompani" sh.p.k. të vendosur në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 151 datë 10.6.2022.

2. Dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë "SA-GLE Kompani" sh.p.k.

3. Ortaku i vetëm i shoqërisë "SA-GLE Kompani" sh.p.k. bëhet shoqëria "AG Hpower & Construction" sh.p.k.

4. Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë "SA-GLE Kompani" sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

5. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë "SA-GLE Kompani" sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti